



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 6.5.2023

Nr: 453

Ora: 12:30

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 369, NGA Z. IVI KASO PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE, NË VENDET E REKLAMAVE NDRIÇUESE, NË AMBIENTET PUBLIKE TË BASHKISË KUKËS, NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 6 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin që i përket:

KËRKUES: Z. Ivi Kaso

OBJEKTI: Kërkohet heqja e materialeve propagandistike statike (postera dhe billborde) të vendosura në rrugët kryesore të Bashkisë Kukës, nga Partia Socialiste e Shqipërisë, dega Kukës.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, neni 79, pika 2, dhe neni 171, pika 1 të Kodi Zgjedhor si dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar denoncimi me nr. 4553 prot., datë 03.05.2023, me denoncues z. Ivi Kaso, regjistruar me nr. 369 ID.

Data: 6.5.2023 Nr: 453
Ora: 12:30



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 369, nga z. Ivi Kaso për afishimin e materialeve propagandistike, në vendet e reklamave ndriçuese, në ambientet publike të Bashkisë Kukës, nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”

Z. Kaso pretendon se *“Në bashkinë Kukës është konstatuar afishimi i materialeve propagandistike në vendet e reklamave ndriçuese, nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe kandidati për kryetar bashkie Kukës, i po këtij subjekti zgjedhor”*.

Pala kërkuese kërkon heqjen e materialeve propagandistike statike (postera dhe billborde) të vendosura në rrugët kryesore të Bashkisë Kukës, nga Partia Socialiste, dega Kukës.

Në përgjigje të këtij ankimi, KQZ filloi hetimin administrativ përkatës. Në kuadër të këtij hetimi administrativ ju kërkua monitoruesit të caktuar nga KQZ për monitorimin e Bashkisë Kukës, nëpërmjet adresës së postës elektronike email, informacion në lidhje me pretendimet e denoncuesit. Nga informacioni i dërguar nga monitoruesi rezultoi se materialet propagandistike janë të vendosura në këto akse rrugore dhe nuk përmbajnë shënimin *“prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të”*.

Në datë 03.05.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi vendimin nr. 424, *“Për heqjen e materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...” (vijon emri i subjektit zgjedhor) nëpërmjet të cilit ngarkohet Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake për heqjen e të gjitha materialeve propagandistike të cilat nuk përmbajnë këtë shënim. Ky vendim u adresohet të gjithë subjekteve zgjedhore që nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor, dhe ngarkon policitë bashkiake dhe Policinë e Shtetit për zbatimin e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.*

Vendimi nr. 424, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i është përcjellë të gjitha bashkive si dhe Policisë së Shtetit, me shkresat nr. 4640 Prot. dhe nr. 4651 Prot., datë 4.5.2023.

Gjithashtu nëpërmjet e-mail të datës 04.05.2023, i është kërkuar subjektit zgjedhor *“Partia Socialiste e Shqipërisë”*, marrja e masave të menjëhershme për heqjen e materialit propagandistik, në kundërshtim me përcaktimet e udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021.

Pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve nga denoncuesi, si dhe raportit të monitorimit vlerësojmë se materialet propagandistike janë vendosur në kundërshtim të nenit 3, pika 1, të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, *“Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”*, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat *“dh”*, *“f”* dhe *“n”*, e pika 2, nenin 79, pika 2, dhe nenin 171, pika 1 të Kodi Zgjedhor, si dhe udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, *“Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”*,

V E N D O S:

1. Urdhërimin e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për heqjen e menjëhershme të materialeve propagandistike në vendet e reklamave ndriçuese, të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në Bashkinë Kukës.
2. Ngarkohen Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake Kukës për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi.
3. Ky vendim t’u njoftohet subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policisë së Shtetit si dhe Policisë Bashkiake Kukës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI